

Shërbimi psiko-social shkollor

Psikologu/punonjësi social, ndër të tjera:

- Bashkëpunon me mësuesit dhe prindërit, identifikon e vlerëson, sa më herët, nxënësit me probleme të sjelljes ose me vështirësi në të nxënë, dhe harton e zbaton për këta nxënës plane individuale parandaluese ose rehabilituese.
- Ndhmon punonjësit arsimorë, prindërit dhe nxënësit në parandalimin ose eliminimin e abuzimeve të punonjësve arsimorë ndaj nxënësve, të nxënësve ndaj nxënësve dhe abuzimeve të vetë nxënësve nga duhani, alkooli, droga etj.

Ndërgjegjësohu! Raporto!


**Raporto një
viktimë trafikimi!
Ngrije zërin nëse sheh,
dëgjon që dikush
po trafikohet!**



Embassy of the United States of America
Tirana, Albania




MINISTRIA E BRENDSIME
TE NJOHJESHEM & TE BARRABARTE



MINISTRIA E BRENDSIME

Ky material është pjesë e projektit të mbështetur financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SH.B.A.-së në Tiranë. Opinione, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të autorit/ve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

Trafikimi është veprimtari kriminale e organizuar në të cilën njerëzit rekrutohen, transportohen, transferohen dhe fshihen nëpërmjet kërcënimit, rrëmbimit dhe mashtrimit duke u trajtuar si mallra me qëllim për t'u shfrytëzuar për:



Shënim:

Trafikimi i të rriturve sipas kodit penal të Republikës së Shqipërisë dënohet nga 8 - 15 vjet burgim. Trafikimi i të miturve dënohet nga 10—20 vjet burgim. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e viktimës dënohet nga 20 vjet deri me burgim të përjetshëm

Një person mund të jetë viktimë trafikimi, kur:

- Kërkon ndihmë se është keqpërdorur, abuzuar, kërcënuar, shfrytëzuar.
- Nuk ka vendbanim të qëndrueshëm, fle në rrugë.
- Shfrytëzohet dhe ka ardhur në situatë shfrytëzimi nëpërmjet rrëmbimit apo nëpërmjet një premtimi të rremë.
- Ndodhet në situatë shfrytëzimi për shkak të kërcënimeve dhe dhunës ndaj tij ose asaj.
- Lëvizjet, strehimi dhe përdorimi i të ardhurave kontrollohen nga persona të tjerë.
- Transporti, lëvizjet, punësimi janë rregulluar nga persona që njihen apo ka informacion se janë trafikantë apo shfrytëzues
- Ka shenja në trup që tregojnë dhunë fizike ose seksuale ndaj tij ose saj.
- Një i mitur shet, punon, ose lyp dhe ka gjithmonë një të rritur pranë që e kontrollon.
- Nuk ka kontakte me familjen, nuk ka person me lidhje gjaku që kujdeset për të.
- Qëndron me persona më të rritur më të cilët nuk ka lidhje familjare

• Premtim i rremë për punë

• Shfrytëzim i situatës së vëshirë të personit i rritur apo i mitur

Si rekrutohet një viktimë trafikimi ?

• Ndikim nga grupi shoqëror për përfshirjen në situatë të rrezikshme për shfrytëzim

• Premtimi i rremë për martesë i dashuri/bashkëjetuesi /bashkëshorti

• Detyruar nga anëtarë të familjes

Shërbimet ekzistuese që ofron Njësia Administrative

• Regjistrim në gjëndjen civile

• Përfitim e ndihmes ekonomike

• Përfitim nga programet e strehimit social

Shënim:

Në zyrat e Njësisë Administrative është vendosur një zyrë e posaçme për mbrojtjen e fëmijëve.

Ku mund të drejtoheni për të kërkuar ndihmë?

Për kontakt urgjent në rast abuzimi, trafikimi të personave të rritur apo të mitur, për të lehtësuar marrjen e shërbimeve, telefoni në:

Linja telefonike kombëtare **116 006**

Komisariati më i afërt i policisë ose

telefononi në nr. **129** ose **112** (pa pagesë);
për të denoncuar rastet e trafikimit apo ato të dyshuara si të tilla.

Punonjësi për mbrojtjen e fëmijëve: (PMF)

• Punon në mënyrë aktive për të identifikuar rastet e fëmijëve në rrezik,

• Vlerëson situatën e fëmijës, nivelin e rrezikut të fëmijëve në nevojë për mbrojtje

• Monitoron mbarëvajtjen dhe progresin e fëmijës, mbështet fëmijën, familjen në planin individual të mbrojtjes etj.

Qëndrat e Formimit Profesional:

Kurset e formimit profesional në Drejtorinë Rajonale të Formimit Profesional Publik janë falas:

- Për punëkërkesit e papunë
- Për disa kategori sociale si: Pjesëtarë të komunitetit Rom; Vajzat dhe gratë e trafikuar; Personat që kanë vuajtur dënimet me burgim; Jetimët (sipas statusit); Personat me aftësi të kufizuara; Emigrantë të kthyer me probleme ekonomike.

Për të përfituar pagesën falas ose të reduktuar për mbarëvajtjen e fëmijëve në kopshte & çerdhe fol me:

- Përgjegjës in e kopshtit / çerdes, i cili të informon në lidhje me dokumentacionin dhe kategorinë e personave që përfitojnë nga ky shërbim.

Në Zyrat e Punës:

- Bëhet regjistrimi si i papunë
- Për punëkërkeset/it ofrohet trajnim për punë.
- Ofrohet mbështetje për punëkërkeset/it që janë në vështirësi (Punëkërkeset/it e papunë që kundërshtojnë pjesëmarrjen në këtë program do të hiqen nga lista e punëkërkesve dhe nuk do të marrin ndihmë financiare dhe as pagesë papunësie)
- Informim për vende të lira të punës
- Ndërmjetësim për punësim
- Këshillim dhe orientim për punë dhe profesion.